

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

SESIONI I

VARIANTI A

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

Lënda: Sociologji

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20** pyetje.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12a	12b	13	14	15
Pikët								
Kërkesa	16	17a	17b	18	19	20		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Realizimi i analizave krahasuese është: **1 pikë**
- A) përparësi e anketës sociologjike
 - B) mangësi e anketës sociologjike
 - C) përparësi e intervistës së lirë
 - D) mangësi e intervistës së lirë
2. Pushtimi i gjatë turk bëri që kultura shqiptare të zhvillohej si: **1 pikë**
- A) nënkulturë
 - B) more
 - C) kundërkulturë
 - D) shok kulturor
3. Modelimi i sjelljeve të fëmijëve prej prindërve të tyre, NUK ka të bëjë me: **1 pikë**
- A) formimin e personalitetit
 - B) shoqërizimin e seks-rove
 - C) ndryshimin e pozicionimeve shoqërore
 - D) zgjedhjen e shoqërisë
4. Nofkat përçmuese janë më të dëmshme në shoqëritë: **1 pikë**
- A) me sistem lidhjesh fisnore më të forta
 - B) më të urbanizuara
 - C) e vendeve në zhvillim
 - D) multietnike
5. Cila formë e lidhjeve martesore ndihmon për ruajtjen e vlerave dhe normave kulturore tradicionale? **1 pikë**
- A) Poligamia
 - B) Ekzogamia
 - C) Monogamia
 - D) Endogamia
6. Një person që ka paragjykime personale, por nuk vepron në bazë të tyre për shkak të trysnisë së grupit ose të kërkesave të ligjit, mund të quhet: **1 pikë**
- A) paragjykues diskriminues
 - B) jodiskriminues pa paragjykime
 - C) diskriminues pa paragjykime
 - D) jo diskriminues me paragjykime
7. Bazë e shumë besimeve fetare ka qenë ndarja e botës në: **1 pikë**
- A) e shenjtë dhe profane
 - B) shtazore dhe bimore
 - C) me zot dhe pa zot
 - D) e mirë dhe e keqe

8. Një qytet shumë i madh, që shoqërisht dhe ekonomikisht mbizotëron një zonë urbane të gjerë quhet: **1 pikë**
- A) metropol
B) megalopolis
C) xhentrifikim
D) eksurbanizim
9. Shtresimi shoqëror: **1 pikë**
- A) është karakteristikë e shoqërisë, pavarësisht nga vullneti i individëve të veçantë
B) është i përgjithshëm, por me tipare të veçanta në çdo shoqëri
C) vazhdon për disa breza
D) përmbush të tria alternativat
10. Rolin e trashëgimisë së profesioneve e gjejmë në shoqëritë: **1 pikë**
- A) tradicionale
B) moderne
C) pasmoderne
D) e paorganizuar
11. Shpjegoni vëzhgimin: **3 pikë**
- a) sistematik _____

- b) e pjesshëm _____

- c) pjesëmarrës _____

12. Arsyetoni mbi ndryshimin në kulturën shqiptare të vlerave të poshtëshënuara në vitet e demokracisë: **2 pikë**
- a) fryma kolektiviste _____

- b) barazia shoqërore _____

13. Shpjegoni: **3 pikë**
- a) devijancën parësore _____

- b) devijancën dytësore _____

- c) lidhjet shoqërore sipas teorisë së kontrollit _____

14. Listoni katër objektiva të tjerë të lëvizjes feministe përveç angazhimit të gjithanshëm për të rritur shkallën e barazisë ndërgjinore. **4 pikë**
- a) _____
b) _____
c) _____
d) _____

15. Jepni përcaktimin sociologjik të koncepteve të mëposhtëm:

3 pikë

a) shoqërizim i parashikuar _____

b) opiniononi publik _____

c) personalitet _____

16. Përshkruani tre funksione kryesore të besimeve fetare, përveç përcaktimit të kuptimit të jetës. 3 pikë

a) _____

b) _____

c) _____

17. Analizoni interpretimin sociologjik të mënyrës së jetesës në qytete sipas Toines në:

a) bashkësi _____

2 pikë

b) shoqatë _____

2 pikë

18. Shpjegoni dy aspekte të lëvizjes shoqërore reformuese.

2 pikë

a) _____

b) _____

19. Krahasoni konceptet:

2 pikë

a) pakicë etnike _____

b) pakicë kombëtare _____

20. Përshkruani dy elemente nga zgjerimi i mundësive për zgjedhje vetjake në shoqërinë moderne.

2 pikë

a) _____

b) _____
